



DEGA NË LIPJAN – OGRANAK U LIPLJANU

P.nr.131/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nexhmije Ahmeti, në lëndën juridiko-penale ndaj të pandehurit B. K., nga fsh.S. K. Lipjan, për shkak të veprës penale Sulm nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së, të cilin e akuzon Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.3871/16 të dt.06.02.2017, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur me 16.10.2018, në prani të Prokurorit të shtetit R. L., dhe të pandehurit në të njëjtën datë merr dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

B. K. i lindur me datë *data e lindjes...*, në fshatin S. Komuna L., ku edhe jeton, nga i ati F. dhe e ëma R. e gjinisë B., me numër personal *numri përsonal...*, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i padënuar mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datën 10.07.2016, rreth orës 20:00h, në L., në fshatin S., në oborin e shtëpisë së tyre, të pandehurit për shkak të një mosmarrëveshje të mëhershme, janë kacafytur në mes veti dhe me dashje e kanë përdorë forcën ndaj njëri tjetrit, në atë mënyrë që e kanë sulmuar njëri tjetrin duke u goditur me grushta,-

-me këtë ka kryer veprën penale Sulm nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së,

Andaj gjykata konformë nenit 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21,73, 85, 86, 187 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 dhe 498 të KPRK-së, të pandehurit i shqipton,

V Ë R E J T J E G J Y Q Ë S O R E

I pandehuri B. K., nga fshati S. K. L., i bëhet me dije se ka kryer një veprë të rrezikshme, që përbën veprë penale dhe nëse kryen persëri veprë të tillë, gjykata do t'i shqiptojë sanksion më të rëndë penal.

DETYROHET i pandehuri që kësaj gjykate në emër të shpenzimeve të procedurës penale pra në emër të paushallit gjyqësor kësaj gjykate t'ia paguaj shumën prej 20.-€, si dhe shumën prej 30.-€, për Fondin e Mbrojtjes së Viktimave të Krimit, në afat prej 15 dite nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzen PP.II.nr.3871/16 të dt.06.02.2017, e ka akuzuar B. K., për shkak të veprës penale Sulm nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i njëjti është bërë në bazë të dispozitave ligjore, me vullnet dhe pa presion andaj i propozoj gjykatës që të njëjtin ta pranoj vullnetare, pa presion dhe konform dispozitave nenit 248 KPRK-së, dhe i propozon gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe nga gjykata ka kërkuar që me rastin e matjes së dënimit, të njëjtit ti shqiptohet një dënim sa më i butë, ngase se të pandehurin e parë e ka vlla, dhe i njëjti që nga pas përfundimit të luftës në Kosovë jeton në botën jashtëme në Amerikë, ndërsa une jetoj në Kosovë me dy vllazër më të vogël dhe një motër të gjithë të pa punë, asnjëherë nuk më ka ndihmuar materialisht, poashtu i njëjti ka deklaruar se i pandehuri i parë është nën ndimimin e narkotikëve dhe ka sjellje jo të mira për këtë ka bërë zhurëm dhe me ka sulmuar mua, i njëjti ka edhe vepra të tjera këtu në Kosovë. Andaj e lut gjykatën që mundësisht në bazë të ligjit ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK-së, gjykata e pranoi pranimin e fajësisë së të pandehurit, për veprën penale Rrezikimi i trafikut publik në neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Me rastin e përcaktimit të llojit të dënimit dhe të lartësisë së tij gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ndaj të pandehurit konform nenit 73 të KPRK-së, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi sjelljen para kryerjes së veprës penale, pra faktin se i pandehuri për herë të parë ka rënë në ndesh me ligjin, gjendjen e jo të mirë ekonomike, i pa punë, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale pra faktin se i pandehuri ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë një veprë të tillë apo të ngjashme, e veqanërisht pranimin e fajësisë, e në mungesë të rrethanave rënduese, gjykata të akuzuarit i shqiptoi vërejtje gjyqësore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se edhe me një lloj të veçantë të sanksionit verbal jondëshkues, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 85 të KPRK-së, që ka për qëllim ti jepet kryesit qortimi kur, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me veprën dhe kryesin, vërejtja gjyqësore është e mjaftueshme për të arritur qëllimin e dënimit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 450 par. 1 dhe par. 2 pika 6 të KPPK-së, ndërsa shuma për të paguar në Fondin e Mbrojtjes së Viktimave u bazua në nenin 39 të Ligjit për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës.

Nga të gjitha arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN

P.nr.131/17, të dt. 16.10.2018.

Sekretarja juridike

Nexhmije Ahmeti

GJYQTAR

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së të njëjtit. Ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate..